



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 17 gusht 2011  
Nr. ref.: RK134/11

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI 18/10**

Parashtruesit

**Z. Denic D. Mladen dhe z. Vitkovic-Deniq D. Milorad**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Cml. – Gzz. nr. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

### **Parashtruesit e kërkesës**

1. Parashtrues janë z. Denic D. Mladen dhe z. Vitkovic-Denic D. Milorad, me vendbanim në Krlevë, Serbi, të përfaqësuar nga z. Vitkovic Branislav, avokat në Krlevë, Serbi.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Cml. Gzz. nr. 36/2007, i 13 dhjetorit 2007, që parashtruesve iu dorëzua më 21 janar 2008.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesit pohojnë që vendimi i Gjykatës Supreme është në kundërshtim me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit (Nr. 03/L-121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) më 24 shkurt 2010.
6. Më 15 mars 2010, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Urdhrin Nr. GJR. 18/10, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Urdhrin Nr. KSH. 18/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Kadri Kryeziu (kryesues), Iliriana Islami dhe Gjyljeta Mushkolaj.
7. Më 12 prill 2011, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Kadri Kryeziu (kryesues), Iliriana Islami dhe Gjyljeta Mushkolaj, e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese Snezhana Botusharova dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

8. Parashtruesit janë trashëgimtarë ekskluzivë ligjorë të z. Danic Dragoljub, babait të tyre të ndjerë, i cili ishte pronar i ngastrës kadastrale 1536/1, një ngastër e tokës në Jagnjillo, ZK Prishtinë. Disa pjesë ishin ekspropriuar pa kompensim më 20 korrik 1946, 3 dhjetor 1947 dhe 20 gusht 1953.
9. Pronësia e tokës zyrtarisht ishte kaluar përmes një kontrate ndërmjet pronarit (Danic V. Dragoljub) dhe Kooperativës së Përgjithshme Bujqësore “Dobrevë e Epërme”. Kjo kontratë ishte nënshkruar më 12 qershor 1961 dhe ishte vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 30 tetor 1962. Kushtet e kontratës parashihnin pagesën e 100.000 dinarëve (2.533,84 Euro në valutën e sotme) për z. Dragoljub si kompensim për tokë.
10. Më 29 janar 1964, “Dobrevë e Epërme” iu bashkëngjiti Kooperativës Bujqësore Industriale “Kosova Export” nga Fushë Kosova. Si rrjedhojë, “Kosova Export” e fitoi pronësinë e tokës.
11. Më 21 shkurt 1997, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin P. nr. 395/96, me të cilin ia kaloi të drejtën e pronësisë së tokës z. Mitrovic Pane Marko. Më vonë u zbulua që Aktgjykimi P. nr. 395/96 ishte dokument i falsifikuar, siç u konfirmua nga prokurori publik i qarkut në Prishtinë me vendimin PP. nr. 415-1/2005. Megjithatë, para se të dihej

që aktgjykimi ishte i falsifikuar, Zyra për kadastër dhe gjeodezi e Komunës së Prishtinës e përdori atë aktgjykim të falsifikuar si bazë për kalimin e pronësisë së tokës tek Marko më 20 gusht 1998 (nr. 208/03).

12. Më 7 mars 1997, parashtruesit e kërkesës ushtruan padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë (P. nr. 236/97), me të cilën kërkonin rikthimin e tokës së paraardhësit të tyre. Procedura mbeti e pezulluar gjatë luftës.
13. Më 19 mars 2004, Marko ua shiti tokën dy blerësve.
14. Më 4 dhjetor 2006, parashtruesit e kërkesës sërish ushtruan padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Me Vendimin SCC-06-0498, të 31 janarit 2007, Dhoma e Posaçme i dha leje Gjykatës Komunale në Prishtinë të vepronte si gjykatë e shkallës së parë, por gjithashtu urdhëroi që ankesat duhej të ushtroheshin në Dhomën e Posaçme.
15. Më 16 prill 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë vendosi, me Vendimin P. Gr. 236/97, që kontrata e 12 qershorit 1961, me të cilën i kalohej toka e kontestuar "Dobrevës së Epërme" ishte lidhur nën kushte të shtërngimit, duke e bërë kështu kontratën të pavlefshme, dhe që e drejta e z. Marko për pronësi ishte sqaruar nga fakti që vendimi i gjykatës të cilin e kishte përdorur për ta fituar pronësinë e tokës ishte i falsifikuar.
16. Prandaj, Gjykata konsideroi që pronari i fundit legjitim i tokës ishte paraardhësi i parashtruesve dhe ua ktheu parashtruesve të drejtën e pronësisë. Gjykata gjithashtu konsideroi që parashtruesit ishin të obliguar t'ia kthenin Kosova Export-it kompensimin e marrë nga paraardhësi i tyre (2.533,84 Euro).
17. Sipas Gjykatës Komunale, ky vendim do të bëhej i formës së prerë (*res judicata*) 15 ditë pas marrjes së vendimit. Parashtruesit e morën kopjen e vendimit të Gjykatës Komunale më 20 prill 2007. Prandaj, sipas udhëzimit të Gjykatës Komunale, vendimi duhet të konsiderohet i formës së prerë që nga 5 maji 2007, kurse, sipas rregulloreve të UNMIK-ut, vendimi duhet të konsiderohet i formës së prerë që nga 20 qershori 2007. Në kërkesën e tyre, parashtruesit e llogarisin periudhën kohore që vendimi të jetë bërë "*res judicata*" duke përdorur rregulloret e UNMIK-ut.
18. Më 6 korrik 2007, pasi vendimi i Gjykatës Komunale, sipas rregulloreve të Gjykatës Komunale dhe të UNMIK-ut, ishte bërë "*res judicata*", prokurori publik paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, P. nr. 236/97. Parashtruesit nuk ishin palë në këtë procedurë.
19. Më 13 dhjetor 2007, Gjykata Supreme nxori Vendimin Cml. – Gzz. nr. 36/2007, me të cilin e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, P. nr. 236/97, dhe ia riktheu padinë për shqyrtim gjykatës së shkallës së parë.
20. Siç duket, seanca për atë rast nuk është mbajtur ende.

### **Pretendimet e parashtruesve**

21. Parashtruesit pohojnë që prokurori publik nuk kishte të drejtë të parashtronte kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.
22. Parashtruesit më tej pohojnë që prokurori publik nuk e parashtroi ankesën në gjykatën e duhur dhe pohojnë që vetëm Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme kishte kompetenca për ta shqyrtuar ankesën, siç ceket në Vendimin e Dhomës së Posaçme, SCC-06-0498.

23. Parashtruesit gjithashtu pohojnë që ankesa e prokurorit publik nuk ishte parashtruar brenda afatit kohor të paraparë me Rregulloren e Dhomës së Posaçme.
24. Për shkak të arsyeve të përmendura, parashtruesit pohojnë që Vendimi i Gjykatës Supreme, Cml. – Gzz. nr. 36/2007, i 13 dhjetorit 2007, shkel nenin 22(1) [Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut], nenin 22(2) [Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut] dhe nenin 22(5) [Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor] të Kushtetutës.
25. Parashtruesit gjithashtu pohojnë që Vendimi i Gjykatës Supreme e shkel nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafin 1 të Kushtetutës, i cili thotë: *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”*.
26. Parashtruesit më tej pohojnë që Vendimi i Gjykatës Supreme e shkel nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, i cili thotë: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*.
27. Së fundi, parashtruesit pohojnë që vendimi i Gjykatës Supreme e shkel nenin 46 [Mbrojta e Pronës], paragrafin 1 të Kushtetutës, i cili thotë: *“E drejta e pronës është e garantuar”*.
28. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që ta anulojë Vendimin e Gjykatës Supreme, Cml. - Gzz. nr. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007, dhe ta rikthejë Vendimin e gjykatës së shkallës së parë, P. nr. 236/97, të 16 prillit 2006.
29. Parashtruesit gjithashtu kërkojnë masa të përkohshme që ia ndalojnë Zyrës kadastrale komunale (Prishtinë) t’i administrojë ndryshimet për pronësinë e pronës për tokën e kontestuar, duke ia ndaluar Drejtorisë për planifikim urban dhënien e lejeve për ndërtim në atë tokë dhe parandalimin e çfarëdo punëve ndërtimore atje.

### **Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme**

30. Parashtruesit kanë kërkuar nga Gjykata vënien e masës së përkohshme ndaj Zyrës kadastrale komunale.
31. Megjithatë, Gjykata konsideron që parashtruesit nuk përmbajnë prova apo arsye të mjaftueshme që mund ta arsyetojnë vënien e masës së përkohshme. Në veçanti, parashtruesit nuk kanë treguar, siç kërkohet me nenin 27 të Ligjit, se do të pësojnë dëme të pariparueshme nëse masa e përkohshme nuk miratohet. Për më tepër, nuk është vërtetuar që vendosja e masës së përkohshme do të ishte në interes publik.
32. Prandaj, kriteret për vënien e masës së përkohshme nuk janë përmbushur dhe kërkesa e parashtruesve duhet të hidhet poshtë.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

33. Sa i përket ankesës së parashtruesve se me Vendimin e Gjykatës Supreme, Cml. - Gzz. nr. 36/2007, u është privuar prona e tyre, Gjykata vëren që për të gjykuar për kërkesën e parashtruesve, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

34. Nga parashtresat e tyre duket që vendimi i Gjykatës Supreme u është dorëzuar parashtresave më 21 janar 2008, dmth., para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe që kërkesën e kanë parashtruar në Gjykatë më 24 shkurt 2010.
35. Prandaj, Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse çështjet e ngritura në kërkesë “janë nën juridiksionin e saj”. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron që nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës mund të kërkohet të përgjigjen për faktet dhe aktet që kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, më 15 qershor 2008. Si rrjedhojë, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë një kërkesë që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës.
36. Sa i përket kërkesës në fjalë, Gjykata vëren që ajo ka të bëjë me çështje që kanë ndodhur para 15 qershorit 2008, dhe, si rrjedhojë, janë jashtë juridiksionit të Gjykatës. Prandaj, Gjykata duhet ta hedhë poshtë kërkesën si *ratione temporis* në mospërputhje.
37. Edhe po të supozohej se mund të ketë situatë të vazhdueshme në rastin në fjalë, nëse shkelja e Kushtetutës ishte shkaktuar nga një akt i kryer para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe pasojat e atij akti origjinal ende ekzistojnë, që i japin kompetencë Gjykatës ta shqyrtojë ankesën, kërkesa është e papranueshme.
38. Në procedurën e 13 dhjetorit 2007, në të cilën parashtruesit nuk ishin të pranishëm, Gjykata Supreme e aprovoi kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 16 prillit 2006, dhe ia ktheu rastin Gjykatës Komunale për rigjykim. Deri më tani, parashtruesit nuk kanë dorëzuar asnjë dëshmi që tregon se Gjykata Komunale tashmë ka caktuar seancë dëgjimore dhe ka marrë vendim për këtë çështje, përveç që në Gjykatën Komunale i kanë parashtruar ankesat e njëjta si në këtë Gjykatë.
39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47(2) të Ligjit, sipas të cilave individët që paraqesin kërkesë në Gjykatë duhet t'i shterin të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.
40. Gjykata thekson se arsyetimi për shterimin e mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë një mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, Vendim i 28 prillit 2004).
41. Kjo Gjykatë përdori të njëjtin arsyetim kur nxori Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti KI-41/09, i 27 janarit 2010, dhe në Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor, Rasti Nr. 73/09, i 23 marsit 2010.
42. Sa i përket rastit në fjalë, nga parashtresat e parashtruesve shihet që, deri më tani, ata nuk i kanë ngritur apo parashtruar shkeljet e supozuara në procedurat në zhvillim e sipër në Gjykatën Komunale apo në gjykatat e shkallëve më të larta; nëse ankesa e tyre në këto gjykata të rregullta nuk do të ketë sukses, atëherë parashtruesit mund të parashtrojnë kërkesë të re në këtë Gjykatë.

43. Prandaj, rezulton që parashtruesit nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47(2) të Ligjit.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe rregullin 56(2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 12 prill 2011, Gjykata Kushtetuese njëzëri

### **VENDOS**


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja Raportuese**



Snezhana Botusharova

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. Dr. Enver Hasani